



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.45, Datë 18.03.2020

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SH.P.K.,
NR. 276, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË, TË MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 37, DATË 18.03.2015.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s Nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 18.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.40/4 Prot, datë 10.03.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 18, datë 31.01.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/6 prot datë 01.02.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k..
- Me shkresën nr. 38/2 Prot., datë 04.02.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 38/3 Prot, datë 18.02.2020, shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e munguar
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 276, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 37, datë 18.03.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 18.03.2020.
- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

Aplikimi i shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatimi dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., me nr. 276, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 37, datë 18.03.2015, duke filluar vlefshmerinë e saj nga data 19.03.2020 për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI